




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr. 33/2023
Prishtinë, më 17.03.2023

Në mbështetje të nenit 28, nenit 29, nenin 35 paragrafi (5), nenin 54 paragrafi 2.3, i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, lidhur me shqyrtimin e ankesës së Operatorëve Ekonomik; Krasniqi Sh.p.k, Aroma Plus Sh.p.k, Schafberger JR GmbH, Beni NTP, Allton Shpk, Pro Tech Clean Sh.p.k, Erik Sh.p.k, për shkak të çregullimit të konkurrencës tregtare lidhur me marrëveshjen në mes të Komunës së Gjilanit dhe NPL “Tregu”, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës në Mbledhjen e mbajtur më datën 17.03.2023 merr këtë:

K O N K L U Z I O N

Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka kushte për të filluar procedurën sipas nenit 35 ndaj Komunës së Gjilanit.

A r s y e t i m

Iniciativa për fillimin e procedurës

Autoriteti i Konkurrencës më 18.05.2022, ka pranuar kërkesën përmes formës elektronike, në email zyrtar lidhur me pretendimet për çregullim të konkurrencës nga Komuna e Gjilanit.

Pretendimet e palëve lidhur me çështjen kundër Komunës së Gjilanit janë si vijon:

Me datë 18.05.2022, Autoriteti i Konkurrencës, ka pranuar kërkesën me Nr. prot. 145/22-01/H, nga grupei i Operatorëve Ekonomik, *Krasniqi Sh.p.k, Aroma Plus, Schafberger JR GmbH, Beni N.t.p, Allton Sh.p.k, Pro Tech Clean Sh.p.k* dhe *Erik Sh.p.k* kundër Komunës së Gjilanit rrëth Marrëveshjes që kanë nënshkruar Komuna e Gjilanit dhe Ndërmarrja Publike Lokale “Tregu”, me datën, 31.05.2022. Me këtë palët pretendojnë për monopolizim të tregut duke nënshkruar marrëveshje me vetëm një kompani për pastrimin e përgjithshëm të objekteve publike siç janë objektet komunale, objektet shkollore, shëndetësore.

Kuvendi Komunal i Gjilanit ka bërë marrëveshje me Ndërmarrjen Publike Lokale “Tregu” që të gjithë punëtorët e sektorit privat (150 punëtorë), të mos u vazhdohet me tutje kontrata për pastrimin e objekteve shkollore, dhe objekteve tjera komunale, shëndetësore, por të gjithë këta punëtor t'i jepen

kësaj ndërmarrje, e që është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse në njëren anë eliminon konkurrencën ndërsa në anën tjetër bënë monopol në treg.

Ankuesit pretendojnë se Ndërmarrja Publike Lokale "Tregu" nuk është ndërmarrje e specializuar për kryerjen e shërbimeve për pastrimin e objekteve, sepse në kodin e veprimitarive nuk e ka veprimitari primare e as sekondare, pastrimin e përgjithshëm të objekteve. Kjo ndërmarrje, tek lista e aktivitetave të regjistruara në ARBK, tek aktivitetet e tjera i figuron veprimitaria 8129 "Aktivitetet e tjera të pastrimit" që nuk ka të bëjë asgjë me pastrimin e objekteve të përgjithshme.

Pra, kur një Aktivitet i Prokurimit publikohet në platformën elektronike atëherë çdo Operatorë Ekonomik duhet t'i plotësojë kriteret të cilat i parashesh LPP (Ligji për Prokurimin Publik) 1. Qarkullimin Financiar, 2. Kontratat e realizuara në lëmin e atij aktiviteti në fjalë p.sh "Pastrimi i hapësirave të brendshme", pastaj për kryerjen e këtyre shërbimeve kompanitë duhet të jenë të pajisura me Certifikatë (LICENCE) adekuat ashtu siç e parashesh ligji, kontrata, referanca. Operatorët Ekonomik duhet të jenë të pajisur edhe me mjete të punës për realizimin e këtij aktiviteti në fjalë. AK i KK Gjilan duhet të vazhdoj me procedura të hapura për zhvillimin e aktivitetave të pastrimit të brendshëm të objekteve shkolllore, komunale dhe shëndetësore që të konkurrojnë Operatorët Ekonomik të cilat i kryejnë këto shërbime.

Marrëveshja në mes të komunës dhe ndërmarrjes Lokale "Tregu" është diskriminuese për operatorët ekonomik, të cilët i kryejnë këto shërbime në Komunën e Gjilanit, i njëjtë e kufizon konkurrencën e tregut dhe i dëmton operatorët e tjere ekonomik që merren me këto shërbime duke krijuar monopol të këtyre shërbimeve, pasi që vetëm një kompani në këtë rast vetëm Ndërmarrja Publike Lokale Tregu mund të kryejë këto shërbime dhe atë pa ofertuar fare, pa hapur tender në lidhje me këto shërbime. Kërkojmë nga Autoriteti i Konkurrencës që të shqyrtojë ankesën e grupit të Operatorëve Ekonomik, ashtu që të jetë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës, sepse në qoftë se këto aktivitete fillojnë të monopolizohen atëherë shumë Operatorë Ekonomik mund të dëmtohen e në rastet më të rënda edhe të falimentojnë.

Shqyrtimi paraprak i tregut relevant dhe korniza ligjore

Autoriteti i Konkurrencës, zhvillimin e procedurës e bazon tek neni 34 - Iniciativa për Fillimin i Procedurës dhe sipas detyrës zyrtare (ex-officio) neni 35 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ana e **ndërmarrjeve** që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 2 i Ligjit Nr. 04/L-226 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës e definon përkufizimin Ndërmarrje sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon:

"Ndërmarrje - çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktivitetave për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist."

Komuna është person juridik. Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gjelqojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gjelqojnë të drejta dhe

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Katë i VI, zyra Nr. 1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks.gov.net

mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve. Komuna e Gjilanit sipas politikës së konkurrencës, nuk konsiderohet ndërmarrje në kuptim të nenit 2 i Ligjit Nr. 04/L-226 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, që kryen aktivitet ekonomik dhe si rrjedhojë nuk operon në treg.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, vlen edhe për ndërmarrjet të cilave, në bazë të rregulloreve të veçanta, u është besuar kryerja e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ndërmarrjeve që për nga natyra e tyre janë monopole dhe që krijojnë të ardhura ose atyre, në bazë të të drejtave të veçanta ose ekskluzive të caktuara, u është besuar kryerja e një veprimtarie të caktuar dhe atë vetëm në rastet kur zbatimi i LMK-së nuk do të pengonte, ligjërisht dhe faktikisht, kryerjen e detyrave që u përcaktohen me rregullore dhe masa të veçanta dhe për të cilat janë krijuar këta persona.

Pretendimet e iniciuesit për fillim të procedurës kundër Komunës se Gjilanit janë çështje që rregullohen dhe administrohen në mënyrë të detajuar me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta, konkretisht me ligjin me , Ligjin nr. 03/l-040 për Vetëqeverisjen lokale, Ligji Nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e pushtetit lokal, si dhe Rregulloren për Menaxhimin e shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes në Komunën e Gjilanit.

Kushtet e hapjes së tenderit, të cilat në thelb kanë të bëjnë me të drejtën për të marrë pjesë, brenda kompetencës dhe fushëveprimit të Autoritetit të Konkurrencës, është çështje e mbikëqyrjes në kompetencë të organeve të administratës shtetërore/qëndrore bazuar në rregullore të veçanta që rregullojnë një çështje të caktuar.

Si rrjedhojë e sa më sipër, Komisioni konstatoi se në rastin konkret nuk ka indikacione për fillimin e procedurës në kuptim të nenit 36 ndaj Komunës së Gjilanit. Për sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve në përputhje me rregulloret e veçanta që rregullojnë fushën lëndore dhe Komunës së Gjilanit si njësi e vetëqeverisjes vendore, Autoriteti i Konkurrencës, duke pasur parasysh kompetencat e saj ligjore, nuk është kompetente në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të veçanta që rregullojnë veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes. Mbikëqyrja e ligjshmërisë së akteve individuale dhe të përgjithshme të njësisë së vetëqeverisjes vendore parashikohet sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Prokurim Publik dhe institucionit qendror për politikën e prokurimit publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), kompetent për mbikëqyrjen administrative mbi zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik dhe akteve nënligjore të tij.

Autoriteti, me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, të organeve qendrore të administratës publike, personave juridikë me autoritet publik dhe organeve lokale jep mendime profesionale për ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut si dhe t'u japë mendim për pajtueshmërinë e ligjeve ekzistuese dhe rregullave tjera me këtë ligj, ofron mendime me të cilat nxitë njohjen për konkurrencën e tregut, respektivisht ngritë nivelin e vetëdijesimit dhe informimit për rolin e ligjit dhe politikën e konkurrencës së tregut, si dhe ofron mendime dhe opinione profesionale për zgjidhjen dhe zhvillimet krahasuese të praktikave në fushën e legjislacionit dhe politikat e konkurrencës tregtare.

Andaj, nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij Konkluzioni

**Autoriteti i Konkurrencës
Komisioni**



Neime Bimaku - Isufi

Kryetare


Kaltrina Sela


Nafije Osdautaj

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Arkiva
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Palëve ankuese

Autoritet i Konkurrencës

Adresa: Rr. Migjeni nr. 21, 10000 Prishtinë. Katë i VI, zyra Nr.1
Tel: +383 /0/ 38 200 109 82 E-mail: info.konkurrenca@rks-gov.net